

VENDIM
Nr. 78, datë 8.2.2006

PËR KRIJIMIN E MATURËS SHTETËRORE DHE PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA PUBLIKE

(Ndryshuar me VKM nr. 323, datë 30.5.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 31 të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e maturës shtetërore, e cila realizon provimet e pjekurisë në përfundim të arsimit të mesëm 4 dhe 5-vjeçar, nëpërmjet vlerësimit të jashtëm. Matura shtetërore të përbëhet nga:

- a) provime të detyruara,
- b) provime me zgjedhje.

2. Arsimi i mesëm quhet i përfunduar kur nxënësi arrin rezultate kaluese në provimet e detyruara.

3. Kanë të drejtë të kërkojnë që të vazhdojnë studimet në shkollat e larta publike, vetëm ata kandidatë, të cilët kanë kryer provimet e maturës shtetërore ose ekuivalentet e saj, për nxënësit, që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit.

4. Ngritjen e Komitetit të Maturës Shtetërore, pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, për drejtimin dhe organizimin e provimeve të maturës shtetërore, përbërja dhe detyrat e të cilit caktohen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

5. Pranimet në shkollat e larta publike, si rregull, të mbështeten në rezultatet e shkollës së mesme, sipas kësaj skeme:

- a) 20 për qind në notën mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme;
- b) 80 për qind në mesataren e notave të provimeve të maturës shtetërore.

6. Për vitin 2008 e në vazhdim pranimet në shkollat e larta publike, si rregull, të mbështeten në rezultatet e shkollës së mesme, sipas kësaj skeme:

- a) 35 për qind në notën mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme;
- b) 65 për qind në mesataren e notave të provimeve të maturës shtetërore.

7. Përzgjedhja e kandidatëve për t’u pranuar në shkollat e larta publike të mbështetet në kriteret e përgjithshme, të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, pas këshillimit me shkollat e larta publike. Këto shkolla mund të përcaktojnë kriteret e veçanta, në përputhje me kriteret e përgjithshme. Për kriteret e veçanta duhet të merret mendimi i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

8. Për shkollat e larta ushtarake dhe për shkollat e larta të policisë kriteret e veçanta vendosen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe, përkatësisht, nga Ministri i Mbrojtjes e nga Ministri i Brendshëm, në përputhje me nenet 2, 3 e 8 të kreut I, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. *Efektet financiare:*

9.1 *për provimet e detyruara, të Maturës Shtetërore, të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;*

9.2 *për provimet me zgjedhje, të Maturës Shtetërore, të përballohen nga një tarifë e vetme për çdo nxënësi/aplikant, prej 2000 lekësh në vit.*

9.2.1 *Nxënësi/aplikanti një kopje të mandatarëkëtimit të pagesës së tarifës së mësipërme e dorëzon së*

bashku me formularin A2 të aplikimit, i cili shërben për krijimin e bazës së të dhënave, të kërkesave të maturantëve për degët, ku duan të konkurrojnë për studime universitare.

9.2.2 Tarifa e provimeve të Maturës Shtetërore arkëtohet nëpërmjet sistemit të bankave të nivelit të dytë ose zyra të postës shqiptare, në adresë të Degës së Thesarit, Tiranë, për Agjencinë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve.

9.2.3 Administrimi i të ardhurave nga tarifa e provimeve me zgjedhje, të Maturës Shtetërore, realizohet nga Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve dhe të ardhurat e siguruar nga kjo tarifë derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

9.3 për pranimet e kërkesave për studim në shkollat e larta publike të mbulohen nga buxheti i shkollave të larta dhe nga tarifa përkatëse, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

11. Të gjitha aktet nënligore për provimet e pjekurisë, të parashikuara në kreun V të dispozitave normative për arsimin parauniversitar dhe urdhrat që mbështeten në to, të cilat bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha